



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
ADMINISTRIMIN E RISKUT NGA SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDEVE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 156, datë 23.10.2020

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të riskut që krijon shoqëria administruese e fondeve.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 16, 26, 27, 33 dhe pikës 5, të nenit 195, të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për shoqëritë administruese të fondeve që janë themeluar në Republikën e Shqipërisë bazuar në Ligjin nr. 56/2020.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato në Ligjin Nr.56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

1. “Administrues i investimeve” është punonjësi i shoqërisë administruese, i cili ka si funksion të tij administrimin e investimeve të fondit;

2. “Fond” është sipërmarrja e investimeve kolektive e themeluar në mbështetje të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
3. “Instrument i ri financiar” është një instrument financiar i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit të cilin shoqëria administruese nuk e ka klasifikuar ende në aktivet e fondit, por synon që ta klasifikojë dhe ta shfrytëzojë si pjesë e investimeve të fondit;
4. “Ligj” është Ligji nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
5. “Prova bazuar në të dhëna historike (back testing)” është procedura e testimit të performancës së një modeli strategjie për periudha të mëparshme;
6. “Prova e rezistencës” është një teknikë simulimi që përdoret për portofolet e aktiveve dhe të detyrimeve për të përcaktuar ndikimin në to në raport me gjendje të ndryshme financiare. Provat janë modele simulimi që testojnë reagimin sipas skenarëve hipotetikë;
7. “Risku i agjencisë” është risku që personat dhe/ose personeli kyç i shoqërisë administruese të përdorin autoritetin e tyre për të përfituar individualisht dhe nuk veprojnë në të mirë të anëtarëve të fondit apo në interes të aksionarëve.
8. “Risku i biznesit” është risku që lind nga ekspozimi i shoqërisë ndaj faktorëve që mund të ulin të ardhurat e saj apo mund ta çojnë atë drejt falimentit;
9. “Risku i kapitalit” është risku i humbjes nga ndryshimet e çmimit të instrumenteve të kapitalit dhe efekti i tyre në vlerën e aktivitetit të një fondi;
10. “Risku i kreditit” është risku i humbjes nga pamundësia që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aktiveve të fondit, të përmbushë pjesërisht apo plotësisht detyrimet e tij sipas kushteve të pranuar;
11. “Risku i kursit të këmbimit valutor” është risku i humbjes nga ndryshimet e kurseve të këmbimit dhe efekti i tyre në vlerën e aktiveve të fondit, në rast se aktivet e fondit investohen në një monedhë të ndryshme nga monedha e përdorur për të llogaritur kthimin nga investimi;
12. “Risku i palës tjetër ose palës së lidhur” është risku që lind nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale nga pala tjetër ose pala e lidhur e shoqërisë administruese;
13. “Risku i likuiditetit” është risku i humbjes kur një pozicion aktiviteti në portofolin e fondit nuk mund të shitet, likuidohet apo mbyllet me kosto sa më të ulët brenda një harku kohor mjaftueshmërisht të shkurtër, duke vënë në rrezik në këtë mënyrë aftësinë e fondit për të përmbushur detyrimet e tij për shlyerje, të përcaktuara në prospekt;

14. “Risku Ligjor” është risku i humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë;
15. “Risku i përqëndrimit” është risku i humbjes nga përqëndrimi i aktiveve të fondit ose në një emetues, në një grup emetuesish që janë palë të lidhura, në emetues që janë në një zonë të caktuar gjeografike, apo në emetues që përfshihen në një sektor të caktuar të ekonomisë;
16. “Risku i shlyerjes” është risku i humbjes kur një transaksion për një aktiv të fondit nuk mund të shlyhet në përputhje me kushtet e pranuar;
17. “Risku i ngjarjes” është risku i humbjes nga rrethana të paparashikueshme që shkaktojnë rënie të vlerës së tregut të një instrumenti financiar në mënyrë të menjëhershme ose të papritur në krahasim me sjelljen e tregut në përgjithësi dhe në një mënyrë që tejkalon shkallën normale të luhatjeve në vlerën e tregut;
18. “Risku i normave të interesit” është risku i humbjes nga luhatjet e normave të interesit dhe efekti i tyre në vlerën e aktivitetit të fondit;
19. “Risku i tregut” është risku i humbjes nga luhatjet në vlerën e tregut të pozicioneve të portofolit të fondit që lidhen me ndryshimet në variablat e tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e aksioneve dhe të mallrave apo klasifikimi i riskut të kreditit të emetuesit;
20. “Risku i vendit” është risku i humbjes kur një autoritet përkatës apo bankë qendrore e një vendi, që nuk mund të përmbushë ose pritet të mospërmbushë detyrimet kundrejt subjekteve jorezidente, si dhe kur debitorët e tjerë, rezidentë të atij vendi dhe për shkak të rezidencës së tyre, nuk mund të përmbushin detyrimet e tyre kundrejt subjekteve jorezidente;
21. “Risku operacional” është risku i humbjes nga procedura të brendshme të papërshtatshme dhe nga mosfunksionimi në lidhje me sistemet dhe stafin e shoqërisë administruese ose palës së lidhur e cila kryen disa funksione të deleguara për shoqërinë administruese, ose që rezulton nga ngjarje të jashtme dhe që përfshin risqe ligjore, risqe dokumentacioni dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregtimit, shlyerjes dhe vlerësimit, të cilat zbatohen nga fondi;
22. “Risku reputacional” është risku i dëmtimit të besueshmërisë së shoqërisë në tregun ku kryen veprimtarinë e saj, duke përfshirë impaktin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht perceptimin e publikut për shoqërinë;
23. “Zbutja e riskut” është procedura që përdoret nga shoqëria administruese gjatë administrimit të aktiveve të fondit për të reduktuar risqet, në përputhje me profilin e riskut.

Neni 5

Sistemi i administrimit të riskut

Shoqëria administruese e fondeve krijon dhe zbaton një sistem për administrimin e riskut i cili përfshin të gjitha procedurat që lidhen me administrimin e risqeve të përkufizuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, si dhe risqeve të tjera që ajo ndesh gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj. Sistemi i administrimit të riskut kryesisht konsiston në:

- a) Zhvillimin e strategjisë dhe politikave të shkruara, të përshtatshme dhe të miratuara nga Këshilli i Administrimit, në lidhje me administrimin e riskut siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregulloreje;
- b) Organizimin dhe ndarjen e përgjegjësisë gjatë administrimit të riskut që duhet të jenë proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të shoqërisë administruese të fondeve dhe të fondit që administrojnë, si dhe në zbatim të strategjisë dhe politikave të miratuara për administrimin e riskut;
- c) Dhënien e informacionit për administrimin e riskut dhe kërkesat për paraqitjen, përmbajtjen dhe shpeshhtësinë e raporteve, siç përcaktohet në nenin 8, të kësaj rregulloreje;
- ç) Krijimin e planeve të rimëkëmbjes dhe të vijueshmërisë, të përshtatshme për administrim të krizave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve dhe çdo fondi që administrojnë;
- d) Krijimin e një sistemi të përshtatshëm për kryerjen e transaksioneve;
- dh) Krijimin e një sistemi për implementimin e instrumenteve të reja financiare si pjesë e administrimit të investimeve të fondit, siç përcaktohet në nenin 10, të kësaj rregulloreje;
- e) Identifikimin, teknikat e matjes, monitorimin dhe zbutjen e risqeve të portofolit të fondit, duke përfshirë sa më poshtë:
 - i. Metodatat e specifikuar për identifikimin e risqeve;
 - ii. Metodatat e specifikuar për matjen e risqeve përkatëse në përputhje me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të shoqërisë administruese të fondeve dhe të fondit që administrojnë. Metoda e përzgjedhur për matjen e riskut, nuk mund të ndryshohet pa arsye;
 - iii. Metodatat e specifikuar për vendosjen e limiteve dhe monitorimin e risqeve;
 - iv. Procedurat e specifikuar për zbutjen e riskut.

- ë) Hartimin e procedurave të nevojshme, për shqyrtimin rregullisht të sistemit të administrimit të riskut, për të kryer në kohë përshtatjet dhe përmirësimet e nevojshme;
- f) Përshtatjen e tij me strukturën e auditimit të brendshëm, siç përcaktohet në nenin 11, të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Strategjia dhe politikat e administrimit të riskut

1. Shoqëria administruese e fondeve duhet të ketë një strategji të administrimit të riskut që dokumentohet, formalizohet dhe është pjesë e procedurave dhe rregullave organizative të shoqërisë e njohur si “politika e administrimit të riskut”.
2. Politika e administrimit të riskut duhet të miratohet, të rishikohet rregullisht, jo më pak se një herë në vit nga personat kyç të shoqërisë administruese të fondeve;
3. Politika e administrimit të riskut duhet të përfshijë të paktën sa më poshtë:
 - a) Përcaktimin dhe formulimin e risqeve që janë pjesë e sistemit të administrimit të riskut;
 - b) Objektivat që lidhen me ekspozimin ndaj risqeve të përcaktuara nga shoqëria administruese e fondeve për secilën sipërmarrje ose nën-fond të investimeve kolektive në përputhje me profilet e tyre të riskut, të cilat duhet të përmbajnë:
 - i. Shkallën e pranueshme të riskut;
 - ii. Pasojat e pritshme që rezultojnë nga ekspozimi ndaj nivelit të pranueshëm të riskut;
 - c) Parimet dhe metodat për identifikimin e risqeve në baza të vazhdueshme;
 - ç) Procedurat teknikat dhe instrumentet që konsiderohen të përshtatshme për të matur faktorët e riskut;
 - d) Vlerësimin e përshtatshëm të përqëndrimit dhe ndërveprimit të risqeve përkatëse në nivelin e portofolit
 - dh) Shpërndarjen e roleve dhe përgjegjësiive ndërmjet strukturave përgjegjëse për sistemin administrues të riskut në shoqërinë administruese të fondeve;
 - e) Kushtet e bashkëveprimit midis njësisë së administrimit të riskut dhe njësisë së administrimit të investimeve për të mbajtur nën kontroll profilin e riskut të sipërmarrjes ose nën-fondit të investimeve kolektive në përputhje me strategjinë e investimit;

- ë) Kushtet, përmbajtjen dhe frekuencën e raporteve mbi performancën e njësisë së administrimit të riskut tek personat kyç të shoqërisë administruese të fondeve;
 - f) Kufijtë e riskut që shoqëria administruese e fondeve zbaton dhe parimet për përzgjedhjen dhe caktimin e tyre;
 - g) Parimet për klasifikimin dhe përdorimin e instrumentave të reja financiare, siç përcaktohet në nenin 10, të kësaj rregullore;
 - gj) Parimet për klasifikimin dhe përdorimin e derivativëve, sipas parashikimeve të ligjit dhe rregullores për Investimet dhe Huamarrjen.
4. Shoqëria administruese depoziton në Autoritet strategjinë dhe politikat për administrimin e riskut brenda muajit janar të çdo viti dhe sa herë që konstatohen ndryshime në to.

Neni 7

Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive gjatë administrimit të riskut

1. Shoqëria administruese e fondeve në organizimin dhe ndarjen e përgjegjësive gjatë administrimit të riskut përfshin sa më poshtë:
 - a) Krijimin e një njësie të veçantë për administrimin e riskut në strukturën organizative të shoqërisë administruese të fondeve, e cila informon rregullisht administratorin e shoqërisë administruese të fondeve, të paktën një herë në muaj. Kjo njësi gjithashtu duhet t'i paraqesë personave kyç të shoqërisë administruese të fondeve një raport për zbatimin e detyrave të njësisë së administrimit të riskut, të paktën një herë në tre muaj;
 - b) Ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të njësisë së administrimit të riskut të shoqërisë administruese të fondeve dhe stafit të saj në nivel organizativ dhe personeli, të përshtatshëm me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve dhe sipërmarrjet nën administrim për të parandaluar konfliktet e interesit;
 - c) Garantimin e burimeve të përshtatshme për të zbatuar strategjinë dhe politikat e miratuara për administrimin e riskut, veçanërisht burimet financiare dhe personelin përgjegjës për kryerjen e funksionit të administrimit të riskut, me aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të përmbushur detyrat që u janë dhënë atyre të përcaktuara në ligj dhe duke siguruar në çdo kohë zëvendësimin e tyre;
 - ç) Politikat motivuese për stafin përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut;

- d) Vënien në dispozicion të informacionit të duhur nga njësia e administrimit të riskut tek njësitë e tjera organizative të shoqërisë administruese të fondeve dhe anasjelltas, siç përcaktohet në nenin 8, të kësaj rregulloreje;
 - dh) Krijimin e kanaleve të rregullta të komunikimit ndërmjet njësisë së administrimit të riskut dhe administruesit të investimeve, me qëllim funksionimin efikas të sistemeve të administrimit të riskut. Administruesit e investimeve janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për investimet në përputhje me kufijtë e risqeve. Njësia e administrimit të riskut është përgjegjëse për matjen e risqeve dhe monitorimin e kufijve të tyre.
 - e) Garantimin që strategjia dhe politikat për administrimin e riskut të njihen dhe zbatohen nga të gjitha nivelet e shoqërisë administruese të fondeve dhe strukturat përkatëse.
2. Shoqëria administruese e fondeve garanton që ndarja e funksioneve të administrimit të investimeve dhe administrimit të riskut është e qartë dhe zbatohet në të gjitha nivelet e strukturës organizative të shoqërisë.

Neni 8

Dhënia e informacionit për administrimin e riskut dhe kërkesat për raportim

1. Njësia e administrimit të riskut jep informacion të plotë çdo muaj ose më shpesh, sipas nevojës për të kryer funksionet operacionale të fondit ose kur kërkohet nga kushtet e tregut, administratorit dhe personave kyç të shoqërisë administruese të fondeve në lidhje me analizën e risqeve ndaj të cilave secili nga fondet nën administrim është i ekspozuar. Monedha në të cilën mbahet aktivet dhe shpërndarja e informacionit duhet të mundësojë administrim efikas të risqeve që ndikojnë dukshëm në performancën dhe rezultatet e sipërmarrjes së investimeve kolektive. Informacioni përfshin sa më poshtë:
 - a) Vlerësimi i nivelit dhe trendit në zhvillimin e riskut;
 - b) Krahasimi i risqeve me rezultatet e tyre të përcaktuara nga shoqëria administruese e fondeve;
 - c) Verifikimi nëse niveli i riskut është në përputhje me kufijtë e brendshëm, aty ku është e aplikueshme;
 - ç) Vlerësimi i vlefshmërisë, përshtatshmërisë dhe përmbushjes së supozimeve të përdorura në matjen e riskut, atje ku është e aplikueshme;
 - d) Vlerësimi i rezultateve të “provave të rezistencës” dhe “back testing”.
2. Staf i përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut duhet të ketë akses në informacione të përditësuara dhe të besueshme për risqet në një kornizë kohore që mundëson analiza në kohë të përshtatshme me kushtet e tregut.

3. Shoqëria administruese e fondeve siguron krijimin e kanaleve të rregullta të komunikimit ndërmjet stafit përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut dhe njërive të tjera të shoqërisë administruese, kryesisht ndërmjet stafit përgjegjës për kryerjen e funksionit të administrimit të investimeve dhe administratorëve.
4. Personat kyç të shoqërisë administruese të fondeve pasi vlerësojnë informacionet në lidhje me nivelet e riskut vijojnë me informimin e stafit përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut, si dhe njërive të tjera të shoqërisë administruese të fondeve.
5. Shoqëria administruese e fondeve duhet të dokumentojë të gjitha rastet kur administrimi i riskut identifikon që kufijtë e brendshëm të përcaktuar në pikën 1, shkronjën c, të këtij neni janë tejkaluar, i cili i vihet në dispozicion Autoritetit menjëherë me kërkesë të këtij të fundit.
6. Shoqëria administruese e fondeve duhet të raportojë në Autoritet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se përpara fillimit të tregtimit në ditën e ardhshme, të gjitha shkeljet e kufijve të investimit të përcaktuara në ligj.

Neni 9

Zbutja e risqeve kryesore

1. Shoqëria administruese e fondeve vecanërisht duhet të monitorojë dhe të zbusë nivelin e risqeve kryesore, të cilat janë: risku i kreditit, risku i tregut, risku operacional, risku i biznesit dhe risku i likuiditetit.
2. Shoqëria administruese e fondeve duhet të zbusë nivelin e riskut të kreditit të fondit duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme:
 - a) Miratimin e kufijve të brendshëm të ekspozimit ndaj riskut të kreditit të fondit sipas profileve të miratuara të riskut dhe verifikimin e përputhshmërisë me këto kufij të brendshëm;
 - b) Miratimin e metodave dhe procedurave për administrimin e riskut të kreditit;
 - c) Identifikimin, matjen, monitorimin dhe uljen e nivelit të riskut të kreditit;
 - ç) Përpunimin dhe sigurimin e informacionit mbi riskun e kreditit për qëllimet e administrimit të këtij risku dhe proceset vendimmarrëse të shoqërisë administruese të fondeve.
3. Për të zbutur nivelin e riskut të tregut, shoqëria administruese e fondeve duhet të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- a) Miratimin e kufijve të brendshëm të ekspozimit ndaj riskut të tregut të fondit në bazë të profileve të miratuara të riskut dhe verifikimit të përputhshmërisë me këto kufij të brendshëm;
 - b) Miratimin e metodave dhe procedurave për administrimin e riskut të tregut;
 - c) Miratimin e metodave, procedurave dhe modeleve për vlerësimin e pozitive që rezultojnë në shfaqjen e riskut të tregut;
 - ç) Vlerësimin e pozicioneve që rezultojnë në shfaqjen e riskut të tregut;
 - d) Identifikimin, matjen, monitorimin dhe uljen e nivelit të riskut të tregut;
 - dh) Përpunimin dhe dërgimin e informacionit mbi riskun e tregut për personat kyç të shoqërisë administruese të fondeve.
4. Shoqëria administruese e fondeve duhet të zbusë riskun operacional duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme:
- a) Miratimin e metodave dhe procedurave për administrimin e riskut operacional;
 - b) Identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e riskut operacional duke përfshirë pa u limituar vetëm në to:
 - i. Pamundësinë për të vazhduar funksionet për shkak të ngjarjeve katastrofike dhe objekteve të backup-it;
 - ii. Rënien e sistemeve që rezulton në pamundësi për të përpunuar kërkesat për shitjen dhe shlyerjen e kuotave si dhe për të kryer llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për kuotë;
 - iii. Dështimi nga ana e nënkontraktorit të tretë siç është depozitari ose administratori i jashtëm për të përmbushur detyrimet;
 - iv. Mosrespektimi i kërkesave rregullatore dhe të përputhshmërisë;
 - v. Gabime që rezultojnë në humbje për investitorët.
 - c) Klasifikimin e ngjarjeve të riskut operacional;
 - ç) Marrjen e masave për zbutjen e riskut operacional, përpunimin dhe dhënien e informacionit mbi riskun operacional për qëllime administrimi dhe vendimmarrjeje.
5. Shoqëria administruese e fondeve duhet të përpiqet të zbusë risqet e biznesit duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme:
- a) Miratimin e metodave dhe procedurave për administrimin e riskut të biznesit;

- b) Identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve të biznesit duke përfshirë pa u limituar vetëm në to:
 - i. Stresin financiar mbi kapitalin rregullator që rezulton nga rënia e aktiveve të administruara;
 - ii. Kthim negativ nga investimet që rezulton në vlerësim negativ nga media dhe investitorët;
 - iii. Praktikën e shitjes mashtruese ose mashtrimet nga shpërndarësit ose agjentët e shitjes.
 - c) Marrjen e masave për të zbutur riskun e biznesit, proceset dhe sigurimin e informacionit mbi riskun e biznesit për qëllime administruese dhe vendimmarrjeje.
6. Shoqëria administruese e fondeve duhet të zbusë riskun e likuiditetit siç përcaktohet në Rregulloren për Investimet dhe Huamarrjen.
7. Shoqëria administruese e fondeve, përveç monitorimit dhe zbutjes së risqeve kryesore të mësipërme, duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për identifikimin, monitorimin dhe zbutjen e të gjitha risqeve të tjera, sipas parashikimeve të ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Instrumente të reja financiare

Shoqëria administruese e fondeve për qëllime të administrimit të riskut, përfshin në procedurat për miratimin, klasifikimin dhe përdorimin e instrumenteve të reja financiare si pjesë e administrimit të investimeve të SIK, sa më poshtë:

- a) Përshkrimin e instrumentit të ri financiar dhe veprimeve që lidhen me të;
- b) Identifikimin e faktorëve të riskut që lidhen me instrumentin financiar;
- c) Analizën e ndikimit të instrumentit financiar të propozuar mbi portofolin e SIK;
- ç) Zbatimin e procedurave që përdoren për matjen, monitorimin dhe auditimin e risqeve që lidhen me instrumentin e propozuar financiar;
- d) Vlerësimin e nivelit të përgatitjes së njësive të veçanta të shoqërisë administruese të fondeve për implementimin e instrumenteve të reja financiare.

Neni 11

Sistemi i auditimit të brendshëm

1. Shoqëria administruese e fondeve krijon dhe të mban një strukturë të auditimit të brendshëm siç përcaktohet në nenin 33, të ligjit si dhe në rastin e delegimit të këtij funksioni vazhdon të jetë përgjegjëse sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 25, të ligjit.
2. Struktura e auditimit të brendshëm të shoqërisë administruese të fondeve në përputhje me kërkesat e sistemit të administrimit të riskut duhet të plotësojë sa më poshtë:
 - a) Krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për kryerjen e auditimit të brendshëm të aktiviteteve të shoqërisë administruese të fondeve, veçanërisht:
 - i. Aktivitetet dhe mekanizmat e kontrollit të kryera nga administratori dhe personat kyç;
 - ii. Aktivitetet dhe mekanizmat e kontrollit të kryer nga stafi i shoqërisë administruese të fondeve në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
 - b) Verifikimi i funksionimit të rregullt të sistemit të administrimit të riskut nga struktura e auditimit të brendshëm e shoqërisë administruese të fondeve, si dhe vlerësimi i efektivitetit të strukturës së auditimit të brendshëm.
3. Struktura e auditimit të brendshëm e shoqërisë administruese të fondeve pas gjetjeve të mangësive në lidhje me administrimin e riskut ndërmerr veprimet e mëposhtme:
 - a) Informon personat kyç ose anëtarët e personelit kyç për gjetjet e identifikuara në lidhje me sistemin e administrimit të riskut të shoqërisë administruese të fondeve;
 - b) Përfshin në raportin e saj rekomandimet për korrigjimin e gjetjeve të konstatuara;
 - c) Propozon ndryshimet e nevojshme dhe rregullime në kohë të sistemit të administrimit të riskut.
4. Shoqëria administruese e fondeve dorëzon në Autoritet raportin e auditimit të brendshëm brenda muajit janar të vitit pasardhës kur është kryer auditimi. Të gjitha njësitë organizative të shoqërisë administruese janë objekt kontrolli nga njësia e kontrollit të brendshëm, të paktën çdo tre vjet, përfshirë edhe ato me rrezik të ulët.

Neni 12
Shfuqizimi

Rregullorja nr. 110, datë 19.07.2016 “Për administrimin e riskut të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, shfuqizohet.

Neni 13
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.